



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:086063

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05697289

KPPP.nr.552/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Ambientit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave, me seli në Prishtinë, kundër debitorit SH.P.K. “Ar-Beton”, me NUI: 810621294, me seli në rr. “Dëshmorët Dervishaj”, në Istog, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.31/23 i datës 13.02.2023, të Përmbartuesit Privat Shpend Ahmetaj, me seli në Istog, jashtë seancës me datë 16.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET POSHTË si i pa afatshëm prapësimi i debitorit SH.P.K. “Ar-Beton”, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 31/23 i datës 13.02.2023 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Shpend Ahmetaj.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Ministria e Ambientit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave, me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit përmbartues - Aktvendimit Nr. 6946-2/22 i datës 22.11.2022, me të cilin ka caktuar zbatimin e përmbartimit, ndaj debitorit SH.P.K. “Ar-Beton”, duke e detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, konform vendimit të lartcekur kreditorit t’ia paguaj shumën prej 1,000.00 € (njëmijë euro), si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm me bllokimin e të gjitha

llogarive bankare të debitorit, si dhe me sekuestrimin, vlerësimin, shënimin e përmbarimit në paluajtshmëri deri në realizimin e borxhit në tërësi.

Debitori në prapësimin e paraqitur me datën 28.02.2023, ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, duke theksuar që vendimi është lëshuar në shkelje ligjore dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike meqenëse arsyetimi i kreditorit nuk përshkon me gjendjen reale të konstatuar në teren. Ka theksuar që dokumenti nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe ka kundërthënë në mes të dokumentit të paraqitur si titull ekzekutiv dhe propozimit për përmbarim. I ka propozuar Gjykatës që prapësimin e debitorit ta pranoj si të bazuar.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i pa afatshëm për arsyet si në vijim:

Sipas vlerësimit të Gjykatës, debitori Urdhrin Përmbarimor P.nr.31/23 të datës 13.02.2023 të lejuar nga Përmbaruesi Privat Shpend Ahmetaj, e ka pranuar me datë 20.02.2023, e cila vërtetohet nga fletë kthesa për dorëzim personal të përmbaruesit privat që gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa prapësimi nga ana e debitorit është ushtruar me datën 28.02.2023.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore përcaktohet se *“Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrin përmbarues”*, ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se *“Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.”*

Andaj duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret, debitori Urdhrin Përmbarimor P.nr.31/23 të datës 13.02.2023 e ka pranuar me datën 20.02.2023, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 21.02.2023, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 27.02.2023.

Meqenëse në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 28.02.2023, e cila vërtetohet nga vula e pranimit-protokollit Nr.76/23 të përmbaruesit privat Shpend Ahmetaj, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat

e tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me një (1) ditë vonesë.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 73 par. 3 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.552/24, datë 16.05.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.